



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna Drenas/Glllogoc

Zyra e Personelit

01Nr. 111-45187 dt. 05.08 /2019

Bazuar në nenin 18, paragrafi 3 dhe neni 27 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 5 i Rregullorës Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, Komuna Drenas/Glllogoc dhe neni 16, paragrafi 1, pikat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.7, të Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, U.D.Udhëheqëse e Personelit bën:

SHPALLJEN E KONKURSIT PËR AVANCIM PËR POZITËN E LIRË

Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave

Emri i institucionit rekrutues: Komuna Drenas/Glllogoc
Nr. i references: RN00005354
Pozita e punës: Udhëheqës i Sektorit të Buxhetit dhe Financave BF/140
Institucioni: Komuna Drenas/Glllogoc
Divizioni/njësia: Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Lloji i pozitës: I Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës: Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit: Drejtori
Kategoria Funksionale – Grada: Drejtues 2, Koeficienti 9.5
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit: Po
Procedura e Aplikimit: I Brendshëm (Avansim)
Numri i kërkuar: 1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit: I përhershëm
Kategoritë funksionale, vendndodhja : Drejtues 2, Koeficienti 9.5, Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Drenas.

Përshkrimi detyrave të punës:

1. Udhëheqësi i Sektorit për Buxhet dhe Financa është përgjegjës për veprimtarin e rregullt dhe të ligjshme financare të organizatës buxhetore;
2. Të siguroi që të gjitha transaksionet të regjistrohen në regjistrin e kontabilitetit;
3. Të siguroi që të gjitha faturat e rregullta të pranuar nga njësit buxhetore të dorëzohen menjëherë për pagim nga sistemi i thesarit;
4. Mbikëqyrë të gjitha aspektet e raportimit buxhetor nga ana e organizatës buxhetore;
5. Ushtrimi i funksionit të dhënë zyrtarit në përputhshmeri të plotë me Ligjin mbi Financat dhe rregullat e kontrollës së brendshme financiare të jetë në përputhshmëri me ligjin;
6. Raporton për punën dhe planin e punës tek Drejtori dhe Kryetari i Komunës, zbaton ligjet mbi financat Publike;
7. Regjistrimi i Buxhetit në Sistem BDMS;
8. Kryen edhe punë të tjera të deleguara nga Drejtori për Buxhet dhe Financa;

Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja paraprake e punës:

Diplomë universitare - Fakulteti Ekonomik – Drejtimi Menaxhmet dhe Financa apo Banka, Financa, Kontabilitet, 4 vite përvojë pune profesionale;

Njohuri dhe përvojë në fushën e menaxhimit të buxhetit dhe financave, shkathtësi të nivelit lartë në menaxhim, caktim të objektivave dhe planifikim;

Njohuri të mira për mbikëqyrje efektive të punës profesionale të kryer nga vartësit, shkathtësi të nivelit të lartë në komunikim dhe negocim;

Fleksibilitet ndaj organizimit dhe mbikëqyrjes së punës, përfshirë zgjidhjen e problemeve;

Shkathhtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Acces);

Një përshkrim i shkurtër i përzgjedhjes si dhe një përshkrim i Rregullorës ekzistuese e cila rregullon çeshtjen e rekrutimit:

Përzgjedhja bëhet në bazë të listës së ngushtë e cila hartohet pas rezultateve të testit me shkrim dhe pas intervistës me gojë në bazë të Rregullorës për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, nr.02/2010 dhe Rregullorës Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë.

Konkursi mbetet i hapur 8 (tetë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit 05/08/2019 deri më 12/08/2019,që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:


Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12,gjatë orarit të punës,Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shërbyesit civil në Komunën e Drenasit dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore .

Aplikacionit i bashkangjitën kopjet e dokumentacionit për kualifikim arsimor dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për këto vende pune,për të cilat konkurohet.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes shpalljes në hyrje të Komunës.



B.D.Udhëheqëse e Personelit

Hamza Shabani